



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1527/1 Prot

Tiranë, më 22.10.2019

**V E N D I M**

Nr.95, datë 22.10.2019

***“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Vau Dejës në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vau Dejës,

**VËREJ SE,**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të

gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (*61 bashkitë e vendit*), ku përfshihet edhe Bashkia Vau Dejës.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Vau Dejës, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Vendimin nr.2, datë 22.1.2019, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, *“Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin buxhetor 2019”*, e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Vau Dejës së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **102** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion kategori e lartë drejtuese, **6** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **25** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **70** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, **33** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **48** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **21** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende vakant.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. \*\*\*\*\*; në pozicionin e punës *“Specialist”*, në Sektorin e Regjistrimit dhe Kontabilizimit, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 164, datë 16.11.2017.
2. \*\*\*\*\*; në pozicionin e punës *“Specialist”*, në Sektorin e të Ardhurave, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 178, datë 09.12.2017.
3. \*\*\*\*\*; në pozicionin e punës *“Specialist”* në Sektorin e të Ardhurave, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 182, datë 29.12.2017.
4. \*\*\*\*\*; në pozicionin e punës *“Inspektor”* në Sektorin e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 112, datë 17.05.2018.

5. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë Ekonomike, emëruar me aktin nr. 72, datë 15.03.2017.
6. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria Ekonomike, emëruar me aktin nr. 149, datë 01.11.2017.
7. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe PAK, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 62, datë 12.04.2018.
8. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Administrator për PAK+NE*”, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 66, datë 12.04.2018.
9. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Shërbimit Social, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 120, datë 12.06.2018.
10. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Strehimi*” në Sektorin e Shërbimit Social, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 68, datë 12.04.2018.
11. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialiste Shëndetësie*” në Sektorin e Arsimit, Rinisë, Sportit, Shëndetësisë, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me aktin nr. 58 prot., datë 06.03.2016.
12. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Jurist*” në Sektorin e Urbanistikës dhe Menaxhimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 168, datë 17.11.2017.
13. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 54, datë 16.04.2018.
14. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Jurist*” në Sektorin e Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 90, datë 26.04.2018.
15. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Kadastrë Hartograf*” në Sektorin e Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 92, datë 26.04.2018.

16. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Kadastrës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 88, datë 26.04.2018.
17. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin e Zhvillimit të Projekteve dhe Bashkëpunimit me OJF, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhim Territorit, emëruar me aktin nr. 113, datë 18.05.2018.
18. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Investimeve, Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr. 84, datë 26.04.2018.
19. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist i Artit dhe Kulturës*” në Sektorin e Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit, Drejtoria e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 58, datë 16.04.2018.
20. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Agronom*” në Sektorin e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, Drejtoria e Zhvillimit Rural, emëruar me aktin nr. 148, datë 01.10.2017.
21. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 60, datë 16.04.2018.
22. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Arkivist*” në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 111, datë 17.05.2018.
23. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Arkivist*” në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 83, datë 26.04.2018.
24. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Zyrën e Integruar me një ndalesë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 76, datë 26.04.2018.
25. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Zyrën e Integruar me një ndalesë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 74, datë 26.04.2018.
26. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Zyrën e Integruar me një ndalesë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 20, datë 09.02.2018.

27. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës*” në Sektorin e Aseteve, Aksioneve dhe Ndërmarrjeve, Drejtoria Juridike dhe Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 81, datë 26.04.2018.
28. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Sektorin Ligjor, Drejtoria Juridike dhe Aseteve Publike, emëruar me aktin nr. 86, datë 26.04.2018.
29. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Drejtor*” në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, emëruar në mënyrë të përkohshme me aktin nr. 14, 06.02.2018.
30. \*\*\*\*\*, emëruar me kontratën e datës 12.11.2018, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës “*Specialist jurist*” në Drejtorinë Ekonomike.
31. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Vlerësimi*” në Drejtorinë Ekonomike, emëruar me aktin nr. 161, datë 24.07.2018.
32. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Punonjës i Shërbimit Social*” pranë Njësisë Administrative Shllak, emëruar me aktin nr. 164 date 03.08.2018.
33. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Psikolog për Mbrojtjen e Fëmijëve*” pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me kontratën e datës 01.10.2018.
34. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist për përfshirjen sociale*” pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr. 193, datë 03.12.2018.
35. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Punonjës Social*” pranë Sektorit të Ndihmës Ekonomike dhe PAK, emëruar me kontratën e datës 01.10.2018.
36. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialiste në Sektorin e Arsimit*” pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, emëruar me kontratën e datës 05.11.2018.
37. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist*” në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me aktin nr. 163, datë 5.8.2016.
38. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialiste agronome*” në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me kontratën e datës 14.11.2018.

39. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialiste*” në ZIN, Njësia Administrative Bushat, emëruar me aktin nr. 166, datë 03.08.2018.
40. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjëse*” në sektorin e Emergjencave Civile, emëruar me aktin nr. 157, datë 03.07.2018.
41. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialiste IT*” në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me kontratën e datës 03.11.2018.
42. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist finance*”, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, emëruar me aktin nr.87, datë 01.07.2019.
43. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist Regjistrim Kontabilizimi*”, në Sektorin e Regjistrimit dhe Kontabilizimit, emëruar me aktin nr.37, datë 16.07.2019.
44. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist shërbimesh publike*”, në Sektorin e Shërbimeve Publike, emëruar me aktin nr.72, datë 01.08.2018.
45. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist shërbimesh*”, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, emëruar me aktin nr.70, datë 01.09.2019.
46. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist investimesh*”, në Sektorin e Investimeve, emëruar me aktin nr.23, datë 01.02.2019.
47. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist kulture*”, në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës, emëruar me aktin nr.37, datë 01.03.2019.
48. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist mjedisi*”, në Sektorin e Mjedisit, emëruar me aktin nr.74, datë 15.8.2019.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, si në rastin e administratës së bashkisë, ashtu edhe të njësive administrative, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të

ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV, “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, duke pasur në vëmendje pikën 8, të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

## Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **48** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të evidentuara nominalisht në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit janë vende vakante, të hartohen përshkrimet e punës sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.
3. Njësia përgjegjëse, të shpallë menjëherë për t’u plotësuar pozicionet e shërbimit civil që, në kuptim të ligjit, janë vende vakante dhe ato të plotësuar në kundërshtim me ligjin dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit, duke realizuar procedurën e rekrutimit në grup për kategorinë ekzekutive.
4. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
5. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes i cili është finalizuar me vendimin paralajmërues nr. 39, datë 19.4.2019, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt, sipas urdhërimeve të dispozitivit të këtij vendimi.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dajeni për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të



zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vau Dejës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Vau Dejës, Ministria e Brendshme, si dhe çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**